Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC
në bashkëpunim me Institutin e Statistikave

STRONG ALBANIAN LOCAL STATISTICS | STATISTIKA TË FORTA VENDORE SHQIPTARE
- SALSTAT -

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave



Tetor 2025 - Mars 2026

Projekti "Statistika të Forta Vendore Shqiptare" (SALSTAT II) është pjesë e nismës "Bashki të Forta", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet në periudhën tetor 2022 - shtator 2026.

Palët kyç të interesit të projektit SALSTAT, përfshijnë INSTAT-in, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, veçanërisht ato të përfshira mbledhjen e të dhënave statistikore dhe/ose përgjegjëse për të dhënat dhe regjistrat administrativë.

Gjatë kësaj faze të re, SALSTAT II do të thellojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare me qëllim mëkimin e besimit në statistikat zyrtare. Gjithashtu, projekti do të angazhojë palët e interesit në lidhje me rëndësinë e statistikave zyrtare për qeverisjen demokratike dhe vendimmarrjen e informuar, veçanërisht duke mbështetur bashkitë në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre, dhe me vendimmarrjen veçanërisht në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të bashkive.

Përmbajtja:

- Mjetet e shpërndarjes digjitale për publikimin e të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë;
- Analiza e të dhënave të censit;
- Zhvillimi i mjeteve të shpërndarjes digjitale për publikimin e të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë;
- Regjistri Statistikor Shqiptar i Ndërtesave dhe Banesave;
- Mbledhja e të dhënave për Anketën e Mbetjeve Familjare 2025;
- Mbledhja e të dhënave e bazuar në rrjet për statistikat e lejeve të ndërtimit;
- Mbledhja e të dhënave në arsimin parashkollor (çerdhet dhe kopshtet publike) në nivel bashkie;
- Trajnimi për statistikat jetësore përmirëson cilësinë e të dhënave në Shqipëri;
- Rritja e besimit tek statistikat dhe Edukimi Statistikor;

EKIPI I SALSTAT

Menaxher projekti:
Ivar Trippolini, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:
Alketa Doçi, Koordinatore për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative
Eralda Pushaj, Koordinatore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore
Edlira Çeliku, Koordinatore Administrative dhe Financiare

Mjetet e shpërndarjes digjitale për publikimin e të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë

1) Ekipi i INSTAT-it për GIS-in dhe ekspertët punuan gjatë nëntorit për "Shpërndarjen e Treguesve Bashkiakë në platformën e re në internet të INSTAT-it (paneli)". Varianti i fundit i panelit u paraqit në Mbledhjen e Komitetit Drejtues të projektit të mbajtur më 25 nëntor 2025.

Gjithashtu, po më 25 nëntor, INSTAT-i ia paraqiti platformën e panelit bashkive në "Konferencën për paraqitjen e rezultateve të Sistemit të Matjes së Performancës dhe Grantit të Bazuar në Performancë" organizuar nga Ministria e Shtetit për Vetëqeverisjen Vendore me prani të Ambasadores së Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.




2) Pas përfundimit të "Shpërndarjes së Treguesve Bashkiakë në platformën e re në internet të INSTAT-it (paneli)" dhe paraqitjes gjatë Mbledhjes së Komitetit Drejtues të projektit të organizuar më 25 nëntor 2025, në dhjetor u organizua seminari për paraqitjen e platformës së panelit të ri stafit të INSTAT-it. Sipas rendit të ditës, sa më poshtë ishin temat kryesore:
   - ✓ Arritjet, vështirësitë dhe zgjidhja e vitit
   - ✓ Paraqitja e platformës së Panelit
   - ✓ Paraqitja e Regjistrit Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB)
   - ✓ Diskutime





Gjatë seminarit pjesëmarrësit u përshëndetën nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Federale Zvicerane të Statistikave Z. Georges Simon Ulrich.

3) Paneli për bashkitë me qëllim lehtësimin e qasjes, analizës dhe paraqitjes pamore të të dhënave statistikore për njësitë e vetëqeverisjes vendore: Projektimi i këtij instrumenti mundëson shfrytëzim të gjerë nga personeli i INSTAT-it në Zyrat Rajonale me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së raportimit dhe përforcimin e rolit të Zyrave Rajonale në qarqet dhe bashkitë ku veprojnë. Më 24 dhe 25 shkurt 2026 u organizuar një trajnim njëditor për Personelin e Zyrave Rajonale të Statistikave për Panelin e Bashkive dhe Sigurinë e Informacionit. Rezultatet në përfundim të trajnimit:

- ✓ Kapacitete të përmirësuara në përdorimin e platformave digjitale të shpërndarjes
- ✓ Përdorim më i mirë i Panelit të Bashkive për angazhim vendor
- ✓ Praktika të përforcuara të sigurisë së informacionit
- ✓ Monitorim më efikas i anketave statistikore





Analiza e të Dhënave të Censit

Puna për parashikimet e popullsisë nisi në fund të vitit 2025 drejtuar nga eksperti i demografisë Z, Arjan Gjonçaj, duke përdorur të dhënat e Censit të vitit 2023. Projeksionet kombëtare dhe rajonale 2025-2050 priten të përfundohen në tremujorin e 2-të të vitit 2026.

Regjistri Shqiptar Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave

Në bashkëpunim me SALSTAT II, INSTAT-i vijoi punën në kuadër të Regjistrit Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB) nëpërmjet një sërë misionesh teknike dhe veprimtarish zhvillimi gjatë periudhës 2025-2026.

Gjatë Mbledhjes së Komitetit Drejtues të projektit më 25 nëntor 2025, u paraqitën rezultatet e Regjistrit Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB). Regjistri në fjalë do të zhvillohet më tej për të zgjeruar treguesit dhe përmirësuar qasjen në statistika zyrtare deri në fund të projektit.

Mbledhja e të dhënave për Anketën e Mbetjeve Familjare 2025

Në mars të vitit 2025, Njësia e Mjedisit dhe Pyjeve në INSTAT shpërndau adresën e internetit për Anketën e Mbetjeve Familjare të vitit 2025 në të 61 bashkitë e vendit dhe mbështeti personelin e bashkive përmes internetit të dorëzonin të dhënat në kohë. Disa bashki kanë personel të ri, që nuk ka marrë pjesë në trajnim, dhe INSTAT-i me mbështetjen e SALSTAT-it do të mundësojnë trajnimin dhe mbështetjen e tyre në terren. Publikimi i të dhënave është planifikuar për në korrik të vitit 2026.

Mbledhja e të dhënave e bazuar në rrjet për statistikat e lejeve të ndërtimit

Sektori i Statistikave Afatshkurtra dhe Turizmit pranë Ndërmarrjeve i INSTAT-it i dorëzoi të gjitha bashkive në tetor të vitit 2025 dhe janar të vitit 2026 *linkun* për mbledhjen e të dhënave bashkiake tremujore për lejet e ndërtimit, përmes platformës në internet.
Rezultatet publikohen çdo tre muaj në faqen e INSTAT-it.

Mbledhja e të dhënave në arsimin parashkollor (çerdhet dhe kopshtet publike) në nivel bashkie

Trajnimi për platformën e mbledhjes së të dhënave në internet për Statistikat e Parashkollorit u organizua gjatë tetorit të vitit 2025 me stafin e bashkive.

Trajnimi trajtoi temat kyçe më poshtë:

- ✓ Kuadrin ligjor dhe rëndësinë e statistikave të parashkollorit në nivel bashkiak
- ✓ Pyetësorin për çerdhet dhe kopshtet
- ✓ Përkufizimet e treguesve dhe metodologjinë e përdorur për mbledhjen e të dhënave
- ✓ Formularin në internet për mbledhjen e të dhënave
- ✓ Shembuj praktikë për plotësimin e pyetësorit në internet me të dhëna elektronike

Trajnimi u organizua në grupe me pjesëmarrës nga secila bashki. Trajnuesit ishin pjesëtarë të Sektorit të Zhvillimit të Statistikave Sociale dhe Departamentit të TI-së në INSTAT. Gjithsej u trajnuan personel nga 49 bashki nga 61 gjithsej, ose nga 80% e të gjitha bashkive.

Linku i anketës në internet iu vu në dispozicion të gjitha bashkive brenda tetorit dhe Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale mbështeti punonjësit me plotësimin e anketës së statistikave të parashkollorit në internet. Bashkitë plotësuan pyetësorin me të dhëna deri në fund të nëntorit 2025.







Në dhjetor u organizuan vizita vijuese për të mbështetur bashkitë: Libohovë, Përmet, Poliçan, Fier, Pukë, Shkodër, Lezhë, Fushë Arrëz dhe Has.





Trajnimi për statistikat jetësore përmirëson cilësinë e të dhënave në Shqipëri

Në kuadër të MM-së ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), në prefekturat e Kukësit dhe Dibrës u organizua trajnimi rreth statistikave jetësore. Nisma synonte përmirësimin e saktësisë së regjistrimeve të lindjeve, vdekjeve dhe martesave, si dhe njohjen me standardet e kodimit sipas ICD-10-s.

- DPGJC-ja trajtoi sfidat ligjore, mbrojtjen e të dhënave personale dhe risqet e pashtetësisë.

•Trajnuesit analizuan dokumentet e statistikave jetësore të vitit 2024 dhe rekomanduan integrimin e kodit të ICD-10-s për të dhënat e vdekjeve.

Pjesëmarrësit ndanë në mënyrë aktive përvojat e tyre, problematikat e identifikuara të të dhënave dhe morën përsipër të zbatojnë praktika të reja. Kjo seancë dyditore përforcoi rëndësinë e të dhënave administrative të besueshme dhe shënoi një hap para në përpjekjet e Shqipërisë për modernizimin e sistemeve të regjistrimit të gjendjes civile.

- ✓ Tetor 2025: Prefektura Kukës (Kukës, Has dhe Tropojë)





- ✓ Nëntor 2025: Prefektura Dibër (Dibër, Mat, Bulqizë dhe Klos)






Rritja e besimit tek statistikat dhe Edukimi Statistikor

1) Më 20 tetor, ekipi i SALSTAT-it mori pjesë në Ditën e Statistikave Botërore dhe Evropiane 2025 të organizuar nga INSTAT/SALSTAT në Hotel Rogner.

Gjatë këtij aktiviteti u mbajt prezantimi kryesor:

- ✓ Kapitulli 18 "Statistika" - Rruga drejt Anëtarësimit
- ✓ Diskutim në Panel të Nivelit të Lartë për "Statistikat Zyrtare si Urë Besimi në Rrugëtimin drejt Anëtarësimit në BE
- ✓ U paraqit: Platforma GeoData/WebGIS e INSTAT-it





2) Në dhjetor të vitit 2025, vizitat studimore në nëntë bashki vlerësuan si njësitë e vetëqeverisjes vendore përdorin statistikat gjatë planifikimit, buxhetimit dhe vendimmarrjes. Gjetjet treguan pranim gjithnjë e më të madh të statistikave si instrument qeverisjeje, megjithëse shfrytëzimi sistematik është ende i kufizuar. Qëllimi kryesor i vizitave studimore të dhjetorit të vitit 2025 ishte të jepej kontribut për punën e SALSTAT-it lidhur me rritjen e besimit në statistika dhe përmirësimin e shfrytëzimit të tyre praktik gjatë vendimmarrjes vendore. Gjatë vizitave u trajtuan tema e mëposhtme:

- ✓ Fuqizimi i edukimit statistikor në nivel bashki, veçanërisht për anëtarët e Këshillit dhe administratorët e lartë, për të përdorur të dhënat gjatë qeverisjes së mirë.
- ✓ Përmirësimi i komunikimit ndërmjet INSTAT-it dhe bashkive, përfshirë udhëzimet për interpretimin dhe përdorimin e të dhënave.
- ✓ Nxitjen e përdorimit të rregullt të statistikave gjatë punës së Këshillit Bashkiak përtej proceseve të miratimit të buxhetit.
- ✓ Mbështetja për bashkitë lidhur me zhvillimin e paneleve të brendshme të të dhënave lidhur me përparësitë vendore.









JU FALËNDEROJMË QË LEXUAT BULETININ TONË INFORMATIV!